



KOMUNA E PRISHTINËS

RAPORT MUJOR

Drejtoria	Drejtoria e Menaxhimit të Hapësirave Publike dhe Parqeve
Periudha raportuese	Muaji Nëntor 2023
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Znj. Donika Cetta Drejtoreshë e Drejtorisë së Menaxhimit të Hapësirave Publike dhe Parqeve

1. PËRMBLEDHJE - Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues.

Drejtoria e Menaxhimit të Hapësirave Publike dhe Parqeve ka vazhduar përgjatë muajit Nëntor, realizimin e detyrave të caktuara në bazë të planit të punës për rekultivimin e hapësirave të gjelbërta si dhe krijimin e hapësirave të reja të gjelbërta dhe parqeve në Komunën e Prishtinës.

2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA - Listoni aktivitetet për muajin raportues të parapara sipas planprogramit dhe fushes së veprimit të Komunës për drejtorinë e Parqeve:

- Përcjellja – mbikëqyrja e punëve në mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbëruara në qytet nga ana e NPL “Hortikultura”, dhe kujdesi ndaj zonave të gjelbërta brenda territorit të Komunës së Prishtinës; krasitja e drunjëve që paraqesin rrezik nga rrëzimi i tyre;
- Përgaditja dhe inicimi i projekteve për tenderim për krijimin e hapësirave të reja rekreative brenda qytetit të Prishtinës;
- Dhënia e pëlqimit për shfrytëzimin e hapësirave të parqeve për aktivitete;
- Dhënia e pëlqimit për shfrytëzimin e Qendrës Rekreative “Gërmia” për aktivitete sensibilizuese dhe edukuese;
- Pranimi i kërkesave dhe ankesave nga qytetarët, shqyrtimi i tyre edhe nga subjektet tjera komunale dhe dërgimi i tyre për personin apo subjektin që i dedikohen;

3. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA:

- Evidentimi i zonave të përshtatshme për krijimin e hapësirave të reja të gjelbërta dhe rekreative në kryeqytet;
- Përcjellja – mbikëqyrja e punëve në mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbëruara në qytet nga ana NPL “Hortikultura”, krasitja e drunjëve dhe prerja e drunjëve që paraqesin rrezik nga rrëzimi i tyre dhe pune të tjera të mirëmbajtjes dhe pastrimit të hapësirave të gjelbërta;
- Krasitja e degëve të drunjëve të cilat paraqesin probleme pas pranimit të kërkesave nga qytetarët.
- Fillimi i punimeve në Parkun e Drenocit;
- Mbjellja e drunjeve në hapësirat e gjelbërta afër Stacionit të trenit, bashkë me donacionin nga FINCA Kosova.
- Bashkë me NLB Banka në kuadër të iniciativës "Ta duam dhe ta mbrojmë natyrën", dhuruan dhe mbjellën drunjë dhe shkurre dekorative në oborrin e shkollës;
- Aktivitet bashkë me EcoZ e perkohur nga European Fund for the Balkans për mbjelljen e drunjeve në parkun e Taukbashqes;
- Regjenerimi i hapësirave të gjelbërta në qendër të qytetit me anë të pastrimit të hapësirave, mbushjes me dhe, mbjelljes së shkurreve dhe drunjeve të rinje;
- Perurimi i “Murit Jeshil” në SHFMU “Xhemajl Mustafa” në kuadër të “Regjenerimit të Hapësirave Urbane” në bashkëpunim me UNDP-në në Kosovë;
- Fillimi i punëve për projektet e iniciativës për “Transformim Urban” bashkë me UNDP Kosovë për krijimin e hapësirave të reja për socializim dhe rekreim për femijë.
- Shkeputja e kontratës “Ndertimi i Parkut Linear” si pasoje e OE jo të përgjegjshëm.

4. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR -

- Përcjellja – mbikëqyrja e punëve në mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbëruara në qytet dhe mbjelljen e tyre nga ana e NPL “Hortikultura”;
- Identifikimi i hapësirave publike për rigjenerim të tyre përmes projekteve;
- Përmirësimi i infrastrukturës në parqet ekzistuese;

5. Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim të sipër

Numri i lëndëve të pranuar: 24

Numri i lëndëve të kryera: 31

Numri i lëndëve të refuzuara: 0

Numri i lëndëve të ceduara: 0

Numri i lëndëve në proces: 0

6. Takime të tjera:

- Takim me Finca;
- Takim me NLB Prishtina.

7. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES –

- Përcjellja e projekteve të gatshme në tenderim;